



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of
Finance, Labour and Transfers

THIRRJE PËR APLIKIM NË MASËN AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS PRAKTIKË NË PUNË

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) hap thirrjen për aplikim në programin “Praktikë në Punë” me kompenzim për 136 të rinjë të cilët do të angazhohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK).

Praktikantët do të jenë të angazhuar në procesin e intervistimit të qytetarëve për anketat e rregullta që realizon Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Çfarë parasheh Masa - Praktikë në Punë?

Përmes masës praktikë në punë të rinjtë do të përfitojnë 170 euro kompenzim mujor përgjatë 6 (gjashtë) muajve sa do të vijojnë praktikën në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK). Kompenzimi i kandidatëve bëhet në kuadër të masës 1.4 - Skema e Garantuar e Punësimit për të Rinj, të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Përveç kompenzimit mujor prej 170 euro, të rinjtë do të kenë mundësi të përfitojnë kompenzim shtesë nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në bazë të numrit të anketave të realizuara.

Kush mund të përfitojë?

Të papunët/punëkërkuar me të drejtë aplikimi janë:

- Të rinjtë me grupmoshë prej 18-29 vjet që plotësojnë kriteret e përshkrimit të vendit të punës që kërkohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK);
- Të rinjtë me notë mesatare në studime më të lartë se 7.0, përparësi do të kenë aplikuesit me notë mesatare më të lartë;
- Përparësi kanë drejtimet: ekonomi, juridik, bujqësi, shkenca politike, shkenca matematikore, sociologji dhe psikologji.

Numri i praktikantëve sipas rajoneve është si vijon:

Rajoni i Gjakovës	Rajoni i Gjilanit	Rajoni i Pejës	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Ferizajit
16 praktikantë	14 praktikantë	12 praktikantë	6 praktikantë	16 praktikantë	56 praktikantë	16 praktikantë

Si të aplikoni?

Dokumentet e mëposhtme dërgohen përmes emailit në: masa1.4@rks-gov.net duke përdorur titullin (subject line): “Punë praktike në ASK: (Komuna për të cilën aplikoni)”.

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Kopja e diplomës/certifikatës së nivelit më të lartë të edukimit që keni;
3. Transkripta e notave;
4. CV-ja.

Kur fillon praktika në punë?

Praktika në punë do të realizohet në periudhën korrik-dhjetor 2022.

Aplikimi është i hapur nga data 15-24 qershor 2022, në ora 16:00.